



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 76/2012
Prishtinë, më 20.09.2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të ftuar: Burim Ejupi dhe Dita Dobranja– INDEP; Shefki Kastrati dhe Flamur Hyseni – NDI; Floriana Shala- OSBE; Sabiha Shala-NACEL; Ibrahim Rexhepi-STRAS; Albert Krasniqi –KPRED;Agron Demi dhe Visar Rushiti-GAP; Gëzim Kolgeci- BEEP/USAID; Florije Mehmeti dhe Isuf Zejna -KDI.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi – ZPRK dhe Kastriot Jahaj-D4D.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për pjesën e dytë të vitit 2012;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për pjesën e dytë të vitit 2012

Kryetari - Fillimisht i falënderoj të gjithë të pranishmet për pjesëmarrje në këtë takim. Arsyeja e takimit tha se është debati rreth Planit të Punës së Komisionit për pjesën e dytë të vitit 2012, në këtë rreth më të gjerë dhe të marrim opinionet tuaja në lidhje me aktivitetet e Komisionit dhe mundësinë e mbështetjes.

Agron Demi (GAP) - Propozoj që Komisioni t'i rekomandojë Qeverisë që t'i sjellë më kohë projektligjet në bazë të Strategjisë legislative, sepse pastaj Komisionet po dalin joserioze edhe me planin e vet të punës kur nuk po realizohet në bazë të asaj së çfarë është paraqitur në Strategji legislative. Po ashtu kërkoj që të bëhet presion edhe në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që ta sjellë në diskutim Strategjinë e Energjisë. Ai tha se GAP do e mbështes Komisionin me hulumtime të projektligjeve dhe mund të ju ofroj mbështetje për Projektligjin për inspektoratet në kohen kur do të procedohet nga Qeveria.

Sabiha Shala (NACEL) – Tha se nuk pajtohet në tërësi me formën e Planit të Punës dhe kërkoj që kur të hartohet Plani për vitin tjetër të përfshihet NACEL në hartimin e Planit të Punës. Ajo shtoj se duhet të kemi parasysh që të përfshihet Agjenda evropiane në masë më të madhe se sa është paraqitur këtu, madje propozoi që të këtë një kolonë të veçantë për sfidat e Raportit të Progresit.

Gezim Kolgeci (USAID-BEEP) – Tha se BEEP-i edhe në të ardhmen do vazhdojë të mbështes Komisionin dhe tani në këtë pjesë të dytë të vitit do ofrojmë mbështetje në projektligjin për inspektoratet dhe projektligjin për lejet dhe licencat.

Burim Ejupi (INDEP) – Tha se ne do vazhdojmë të mbështesim Komisionin edhe më tej sikurse kemi bërë deri me tani. Ai njoftoi se INDEP e ka përfunduar punën me monitorimin e ligjit për eficienten e energjisë dhe do ia dorëzojë Komisionit materialin e nevojshëm. Po ashtu tha se jemi në fazën finale për të organizuar një tryezë së bashku me ju, ku do të diskutohet legjislacioni në fushën e eficientes së energjisë.

Floriana Shala (OSCE) – Tha se OSBE në programet e saj ka në mbështetje tani me disa komisione parlamentare, mirëpo edhe komisionin tuaj do e mbështesim në fushën e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe të institucioneve të pavarura.

Shefki Kastrati (NDI) – Tha se NDI do të mbështes Komisionin edhe në të ardhmen në katër fusha si me konsulent ligjor, bashkëfinancim të ekspertëve, monitorimin e ligjeve dhe organizimin e tryezave dhe punëtorive.

Ibrahim Rexhepi (STRAS) – Tha se ne jemi një organizatë e re e cila merret me hulumtimet e opinionit në rrafshin ekonomik dhe social. Ne do jemi të gatshëm të bashkëpunojmë më Komisionin edhe në fusha të tjera, si në fushën e privatizimit të ndërmarrjeve publike.

Albert Krasniqi (KIPRED) – Tha se KIPRED-i kryesisht është i angazhuar në fushën e mbikëqyrjes së financave publike, andaj nëse Komisioni ka një interes të tillë në do ju asistojmë në këtë drejtim.

Lutfi Zharku – Tha se është për të përshëndetur përkrahja që kemi nga shoqëria civile, sepse tani më kemi ekspertiza të sakta kur Komisionit i duhen. Mirëpo tha se Plani i punës duhet të këtë disa përmirësime në lidhje me punën që kemi bërë deri me tani, sepse janë të evidentuara projektligje ose çështje të përfunduara, ndërsa ne kemi këtu të evidentuara si të pashqyrtuara.

Visar Ymeri – Tha se edhe të korrigjohet pjesa e mbetur e Planit të punës dhe të këtë shpërndarje të projektligjeve në muajit tjerë, e jo vetëm në tetor dhe kërkoj se në raste të organizimit të konferencave ose tryezave të ceket saktë se për çfarë teme do të organizohen, e jo siç janë të evidentuara vetëm për zhvillim ekonomik.

Myzejene Selmani – Tha se nuk është faji i Komisionit për mos shqyrtimin e projektligjeve në plan, sepse pa i sjell Qeveria ne nuk kemi se si t'i shqyrtojmë. Dhe kërkoj që mos të kemi ne, si Komision, vizita në Ministri, por ministrat të vijnë dhe të raportojnë në Komision.

Hashim Deshishku – Tha se duhet të barten projektligjet për shqyrtim nga muaji tetor në atë nëntor dhe të mos lihen në dhjetor, sepse në atë kohë është fundi i vitit dhe fillojnë festat.

Kryetari – Tha se qëllimi ynë u arrit sepse në kemi dashur po këtë debat dhe tani më në bazë të këtij debati stafi i Komisioni do të hartojë planin e punës për këto muaj që kanë mbetur deri në fund të vitit. Ai inkurajoj të gjithë të ftuarit që të vazhdojnë të mbështesin Komisionin dhe të keni parasysh se si deputet kanë nevojë që të marrin përvojat e vendeve të tjera, si në fushën e hartimit të legjislacionit, por edhe në atë të monitorimit të zbatimit të ligjit.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

V E N D I M

1. *Ndryshohet dhe plotësohet Plani i Punës se Komisionit për pjesën e mbetur të vitit 2012.*
2. *Autorizohet Njësia mbështetëse e Komisionit që në bazë të debatit të bëjë ndryshimet dhe plotësimet e Planit të Punës së Komisionit.*

3. Të ndryshme

Çështje vijuese;

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit